



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Në pajtim me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28 shtator 2016, miratoi këtë:

Politikë për Mbikëqyrje të Sistemeve të Pagesave

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj politikeje është përcaktimi i parimeve dhe udhëzimeve për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të cilët operojnë në Republikën e Kosovës.
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (tani e tutje: BQK) synon forcimin e mëtejshëm të politikave të saj mbikëqyrëse në kuadër të sistemit të pagesave.

Neni 2

Fushëveprimi

Politika për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave është e zbatueshme për të gjitha sistemet e pagesave që operojnë në Republikën e Kosovës. Të gjitha aktet juridike të mbikëqyrjes lidhur me sistemin e pagesave, duhet të jenë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë politikë.

Neni 3

Përkufizimet

1. Të gjitha përkufizimet në Politikën për Mbikëqyrjen e Sistemit të Pagesave kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç përkufizohen në ligjin për sistemin e pagesave.

27.

Neni 4
Roli dhe aktiviteti i mbikëqyrjes

1. BQK-ja në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës për sistem të pagesave, angazhohet në këto aspekte:
 - 1.1. Monitoron zhvillimet në kuadër të sistemit të pagesave dhe shlyerjes, duke vlerësuar efikasitetin dhe rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuara sistemet e pagesave;
 - 1.2. Përcakton parimet dhe standardet e mbikëqyrjes, me qëllim të sigurimit dhe funksionimit të sigurt dhe efikas të sistemit të pagesave dhe shlyerjes;
 - 1.3. Analizon të dhënat dhe informatat mbi aktivitetin e sistemit përmes raportimeve, inspektimeve në vend apo takimeve me operatorët e sistemit të pagesave;
 - 1.4. Vlerëson pajtueshmërinë e sistemit të pagesave me standardet dhe parimet e përcaktuara nga BQK-ja.

Neni 5
Objektivat e mbikëqyrjes

1. Përmes ushtrimit të funksionit mbikëqyrës të sistemit të pagesave, BQK-ja është e fokusuar në arritjen e këtyre objektivave:
 - 1.1. Të sigurojë qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të pagesave, duke kërkuar nga subjektet e mbikëqyrura të identifikojnë rreziqet dhe të marrin masat e nevojshme, për t'i shmangur gabimet në ndërtimin dhe funksionimin e sistemit;
 - 1.2. Të arrijë një nivel të kënaqshëm efikasiteti të sistemit të pagesave;

Neni 6
Sistemi i pagesave

1. Në Kosovë operon një sistem i vetëm ndërbankar i pagesave i cili operohet dhe mbikëqyret nga BQK-ja.
2. Përmes Ligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave përcaktohen rregullat, standardet dhe kushtet për operimin e sistemeve.

Neni 7 Instrumentet e pagesave

1. Sipas Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës nr.03/L-209, BQK-ja mund të rregullojë dhe të mbikëqyrë vënien në qarkullim dhe cilësinë e instrumenteve të pagesave, duke i konsideruar ato si pjesë përbërëse të sistemit të pagesave në Kosovë, me qëllim që të garantojë efikasitetin dhe sigurinë e tyre.
2. Instrumentet e pagesave përfshijnë këto instrumente:
 - a. Kartelat për pagesa;
 - b. Transferi i kreditit;
 - c. Debitimi direkt;
 - d. Kos Giro;

Neni 8 Metodologjia e mbikëqyrjes

1. BQK-ja ushtron funksionin e mbikëqyrjes së sistemit të pagesave përmes një procesi i cili kalon nëpër tri faza: monitorimi, vlerësimi dhe nxitja e ndryshimeve.
 - 1.1. **Monitorimi**- është faza e parë e aktivitetit të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave dhe shlyerjes. BQK-ja përdor burime të ndryshme të informacionit nga operatorët e sistemit, dokumenteve të ndryshme nga operatorët, si dhe raportet nga pjesëmarrësit në sistem. Duke u bazuar në Rregulloren për Statistikat e Instrumenteve të Pagesave BQK-ja, mbledh informatat e nevojshme në periudha të rregullta apo edhe ad hoc lidhur me sistemin dhe instrumentet e pagesave.

BQK-ja mund të vizitojë zyrat e sistemit të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe të pjesëmarrësve të tyre për të kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe evidencat e tjera, për të marrë informacione të ndryshme nga to apo ndonjë masë tjetër, që do të konsiderohet e nevojshme apo e këshillueshme.
 - 1.2. **Vlerësimi**- BQK-ja bën vlerësimin e informatave dhe dokumenteve të grumbulluara gjatë fazës së monitorimit. Mbështetja në standarde dhe rekomandime lejon që mbikëqyrja sistemike e harmonizuar e sistemit të pagesave dhe shlyerjes, të jetë e drejtpërdrejtë dhe e qartë në zbatimin e saj praktik dhe të ndihmojë në krahasimin e rezultateve të vlerësimit për sisteme të ndryshme.
 - 1.3. **Nxitja e ndryshimeve**- Në bazë të rezultatit të mbikëqyrjes, BQK-ja merr veprime kur konstaton, se një sistem i veçantë në kuadër të infrastrukturës së përgjithshme të pagesave, kliringut dhe shlyerjes, nuk ka një shkallë të mjaftueshme të sigurisë.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, BQK-ja i kushton rëndësi bashkëpunimit të mirë me subjektet që ka nën mbikëqyrje, një bashkëpunim konstruktiv ndihmon për të siguruar mbikëqyrje efektive dhe për të minimizuar çdo barrë për subjektet e mbikëqyrura. Megjithatë, përgjegjësia për të siguruar sistem të sigurt dhe efikas mbetet detyrë e subjekteve të mbikëqyrura.

Neni 9

Mjetet për mbikëqyrje

1. BQK-ja ka përgjegjësi dhe detyrim të mbikëqyrë të gjitha çështjet të cilat mundësojnë funksionimin e rregullt të sistemit të pagesave dhe shlyerjes, si dhe infrastrukturat e tregut financiar të cilat operojnë në Kosovë.
2. BQK-ja kryen mbikëqyrjen e sistemit të pagesave nëpërmjet:
 - 2.1. Përcaktimit dhe vendosjes së standardeve për mbikëqyrje;
 - 2.2. Diskutimit me operatorin në rast ndryshimesh në hartimin e rregulloreve operacionale të sistemit dhe marrëveshjeve për hapa të mëtejshëm;
 - 2.3. Marrjes së informacionit publik dhe konfidencial;
 - 2.4. Aplikimit të ndëshkimeve apo kufizimeve të aktivitetit;

Neni 10

Parimet për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave

1. Në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës të sistemit të pagesave dhe shlyerjes, BQK-ja bazohet në parimet dhe standardet e pranuar ndërkombëtare, siç janë:
 - 1.1. Për sistem të pagesave të rëndësishme sistemike aplikohen parimet për infrastrukturat e tregut financiar (BIS 2012);
 - 1.2. Për sistem të pagesave me vlera të vogla aplikohet kuadri i rishikuar për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave me vlerë të vogël (BQE);


Neni 11

Bashkëpunimi me autoritete të tjera

1. Bashkëpunimi është një mjet i rëndësishëm për të siguruar një mbikëqyrje efektive sa herë që subjektet e mbikëqyrura kontrollohen nga autoritete të ndryshme. Një nga detyrat e përcaktuara në parimet për infrastrukturat e tregut financiar nga Komiteti i Sistemeve të Pagesave dhe Shlyerjes (BIS 2012, Paragrafi E për sistemin e pagesave) është bashkëpunimi me autoritetet e tjera.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Politikë hyn në fuqi në datën e miratimit.



Bedri Hamza

Kryesues i Bordit Ekzekutiv